



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr./aq/Br.str. 89
Data/Datum 31.03.2022

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2020, pas shqyrtimit të Rekomandimeve të dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa me Nr. 83, të datës 24.03.2022, për rishqyrtimin e kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për shfuqizimin e vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022, sipas shkresës me Nr. 020-144/5, të datës 24.02.2022, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 53, të Ligjit për Procedurën Administrative Nr. 05/L-031, (Gazeta Zyrtare Nr. 19/2016), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022

1. Për shfuqizimin e vendimit Nr. 22, të datës 07.02.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-144/5, të datës 24.02.2022 dhe Rekomandimeve të dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, me Nr. 83, të datës 24.03.2022, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 23 të datës 20.01.2022, për themelimin e tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 207, të datës 10.03.2022, paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 6 paragrafi 1, 2, 3 dhe nënparagrafët 3.1, 3.2 dhe 3.3, të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M

Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës Drejtorit/es të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës Drejtorit/es të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovës.
2. Për rekrutimin e kandidatëve për konkursin për Zëvendës Drejtor/e të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' në Fushë-Kosovë përzgjidhet Komisioni në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 2.1 Miranda Sylejmani - anëtare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 2.2 Sadri Emini - Zëvendës drejtor në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', aneksi i shkollës në lagjen e Dardanisë në Fushë-Kosovë;
 - 2.3 Arian Mustafa - anëtar i Komisionit, nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit;
 - 2.4 Krenare Azizi - në cilësinë e vëzhguesit;
 - 2.5 Gazmend Bekolli - në cilësinë e vëzhguesit;

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr./No. 91
Data/Datum 31.03.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas rishqyrtimit të Propozimit Nr. 79, të datës 16.02.2022, paraqitur nga Kryetari i Komunës, mbështetur në kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës me Nr. 672, të datës 18.06.2021 dhe shqyrtimit të Rekomandimeve të dalura nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa me Nr. 83, të datës 24.03.2022, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), neni 21 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës Nr. 06/L-092, (Gazeta Zyrtare Nr. 10/2019), nenin 24, nenin 25 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për Stacionin e Policisë së Kosovës në Fushë Kosovë sipas rasteve të veçanta

1. Për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të Komunës së Fushë-Kosovës për Stacionin e Policisë sipas rasteve të veçanta, me numër të certifikatës së pronës P-72514036-00696-0, në Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë, me destinim për ndërtimin e Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë.
2. Dhënia e pronës komunale në shfrytëzim bëhet për nëntëdhjetë e nëntë vite, për institucionin e Ministrisë së Punëve të Brendshme - Stacionin e Policisë në komunën tonë.
3. Qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim, është ndërtimi i Stacionit të ri të Policisë në Komunën e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Gjeodezisë Kadastrit e Pronës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 55, të datës 07.03.2022.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së PU, Policisë së Kosovës në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKTORJA ZA ADMINISTRACIJU
Nrfaq/Br.str. <u>92</u>
Data/Datum. <u>31.03.2022</u>
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 239, të datës 15.03.2022, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, g, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.2, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, f, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 239, të datës 15.03.2022 për lirim nga taksat komunale për ushtrimin e aktiviteteve biznesore të subjekteve afariste në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin kalendarik 2022

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 239, të datës 15.03.2022, për lirim nga bizneset nga pagesa e taksës komunale për vitin 2022, për të gjitha subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike dhe biznesore në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në funksion të krijimit të lehtësimeve për bizneset ekzistuese dhe avantazhe për hapjen e bizneseve të reja dhe gjenerim të punësimit.
2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë për ZHE dhe Arkivës.


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 151, të datës 15.03.2022, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (o), nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (k), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për formimin e 'Komisionit për emërtimin, plotësimin-ndryshimin e emërtimeve të rrugëve dhe vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në përbërje prej:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.2 Jahush Krasniqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.3 Shpend Bardiqi - anëtar i Kuvendit, anëtar;
 - 1.4 Aida Alimi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.5 Qëndresa Ademi - anëtare e Kuvendit, anëtare;
 - 1.6 Samir Shahini - Drejtor për Arsim, anëtar;
 - 1.7 Besnik Shala - Drejtor për Kulturë Rini dhe Sport, anëtar;
 - 1.8 Ejup Qyqalla - Shef i Shërbimeve Publike, anëtar;
 - 1.9 Antigona Sahiti - Shefe e Planifikimit Urban, anëtare;
 - 1.10 Bekim Rexha - Zyrtar për Regjistrimin e Adresave, anëtar;
 - 1.11 Xhevdet Qirriqi - Përfaqësues nga Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e Vendimit është 'Emërtimi i rrugëve të reja, shqyrtimi i ankesave të ndërlidhura me plotësim ndryshimin e emërtimeve të rrugëve ekzistuese dhe emërtimin e vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Mandati i këtij Komisioni fillon nga hyrja në fuqi e këtij vendimi e deri në përfundim të mandatit zgjedhor 2021-2025. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe protokollimit në librin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së PU, dhe Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 73, të datës 15.03.2022, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14, nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike

1. Për themelimin e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Fisnik Sllamniku - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Leona Bërbatovci - përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.3 Habib Mekolli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, anëtar;
 - 1.4 Agnesa Breznica - anëtare dhe
 - 1.5 Shemsi Kelmendi - anëtar.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike janë të definuara në nenin 6, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.
3. Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike zgjidhen nga anëtarët e komitetit.
4. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
5. Raportimi për punën e tyre është raportim vjetor në Kuvendin e Komunës, kurse kompenzimi i anëtarëve të komitetit, bëhet nga buxheti i komunës për gjashtë mbledhje në vitë, sipas nenit 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera.

6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Planifikim Urban Infrastrukturë dhe Shërbime Publike, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Mr./aq./Br.str. 95
Datë/Datum. 31.03.2022

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
FUSHË-KOSOVË

Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 150, të datës 15.03.2022, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), nenin 43, shkronja (h), nenin 48, paragrafi 48.2, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 4, të Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim të Propozimit për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit public

1. Për aprovimin në parim të Propozimit Nr. 150, të datës 15.03.2022, për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale dhe dërgimin e saj në procedurën e diskutimit publik.
2. Me ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale, propozohet themelimi i tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, do të ofrojnë informata e sqarime të nevojshme për opinionin publik, lidhur me propozimin për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014, për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale, për themelimin e tre Drejtorateve të reja të Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Për kryerjen e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 15.03.2022

Në mbështetje të nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 58, shkronjan (m), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), nenin 43, shkronja (h), nenin 48, paragrafi 48.2, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 4, të Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014 dhe bënë këtë:

Propozim për ndryshim-plotësimin e Rregullores Nr. 125, të datës 25.09.2014 për organizimin kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale

Neni 1

1. Neni 4, paragrafi 1, pika 1.6 ndryshohet dhe riformulohet në Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrit;
2. Neni 4, paragrafi 1, plotësohet me pikat si në vijim:
 - 2.1 Drejtoria e Infrastrukturës;
 - 2.2 Drejtoria e Pronës dhe
 - 2.3 Drejtoria e Teknologjisë Inovacionit dhe Integritimeve Evropiane.

Neni 2

Neni 19, paragrafët 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19, të rregullores bazë fshihen.

Neni 3

1. Neni 33 i Rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet në Drejtoria për Planifikim Urban;
2. Neni 33 paragrafit 13 i rregullores bazë i fshihet fjala projektim.
3. Neni 33 paragrafi 16 i rregullores bazë fshihet.

Neni 4

Neni 34 paragrafi 2 i rregullores bazë fshihet dhe riformulohet në Sektorin për leje ndërtimore.

Neni 5

Sektorin për leje ndërtimore

1. Neni 36 i rregullores bazë të titulli fshihet dhe zëvendësohet me Sektorin për leje ndërtimore.
2. Neni 36 paragrafët 1, 2, 3, 4, 5, 6 të rregullores bazë fshihen dhe plotësohen me paragrafët si në vijim:

- 2.1 Informon për shqyrtimin e kushteve ndërtimore dhe lejeve ndërtimore sipas procedurave të parapara me Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale të Komunës;
- 2.2 Shqyrton kërkesat për informim mbi lokacionin e ndërtimeve për kategorinë e parë dhe të dytë të ndërtimeve;
- 2.3 Shqyrton aplikacionet për dhënien e kushteve ndërtimore;
- 2.4 Shqyrton aplikacionet për dhënien e lejeve ndërtimore;
- 2.5 Shqyrton kërkesat për pajisjen me certifikatën e përdorimit të objekteve ndërtimore;
- 2.6 Mban evidencë për të gjitha lejet e lëshuara ndërtimore për territorin e komunës;
- 2.7 Shqyrton kërkesat për trajtimin e ndërtimeve pa leje në territorin e komunës;
- 2.8 Mban evidencë për procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje ndërtimore;
- 2.9 Kryen punë tjera procedurale për pajisjen me leje ndërtimore për subjektet e ndryshme;
- 2.10 Bën vlerësimin e punës së personelit në Sektorin e lejeve ndërtimore dhe raporton për punën e sektorit.

Neni 6

1. Neni 37 i Rregullores bazë të tituli fshihet fjala pronë dhe riformulohet Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër.
2. Neni 37 i rregullores bazë fshihen paragrafet 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Neni 7

1. Neni 38 i rregullores bazë për organizimin e Drejtorisë riformulohet në Drejtorinë për Kadastër dhe Gjeodezi;
2. Neni 38 paragrafi 1 dhe 2 i rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet:
 - 2.1 Sektori për Kadastër dhe
 - 2.2 Sektori për Gjeodezi.

Neni 8

1. Neni 39, paragrafët 3, 4 dhe 10 mbeten kompetenca në përgjegjësinë e Sektorit për kadastër.
2. Neni 39, paragrafët 1, 2, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11 mbeten kompetenca në përgjegjësinë e Sektorit për Gjeodezi.
3. Neni 39, paragrafi 12, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:
 - 3.1 Bën vlerësimin e punës së personelit të sektorit të kadastrit dhe raporton për punën e sektorit
 - 3.2 Bën vlerësimin e punës së personelit të sektorit të gjeodezisë dhe raporton për punën e sektorit

Neni 9

Neni 40 i rregullores bazë për sektorin e pronës fshihet.

Neni 10

Pas neni 66 të rregullores bazë, shtohen Drejtoritë Komunale të caktuar në nenin 1, paragrafi 2, të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Drejtoria e Infrastrukturës

1. Harton programin zhvillimor afatgjatë dhe afatmesëm të infrastrukturës në nivel të komunës, në përputhje dhe në bashkëpunim me bashkësitë lokale dhe në harmoni me zhvillimin urbanistik të vendbanimeve dhe viseve rurale;

2. Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
3. Përgatit detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës lokale dhe rurale;
4. Harton projektet e vogla të infrastrukturës, sipas kërkesave të bashkësive lokale;
5. Lëshon leje për ndërtim të infrastrukturës rrugore dhe leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike si dhe leje për kyçe individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës;
6. Cakton organin mbikëqyrës, për mbikëqyrjen dhe komisionin për kontrollim teknik të objekteve të ndërtuara, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit;
7. Është përgjegjëse për menaxhimin, mbikëqyrjen e ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore kanalizimet fekale, atmosferike, kabllore, ujësjellësin, asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal në qytet dhe vise rurale;
8. Kontrollon dhe mbikëqyrë cilësinë dhe ngjeshmërinë e materialit ndërtimor, nëpërmjet laboratorit të licencuar për përputhshmërinë me norma teknike të pranuar në nivel ndërkombëtar dhe të Bashkimit Evropian;
9. Bashkëpunon me organin e prokurimit, me qëllim të jetësimit të kontratave të nënshkruara për kryerjen e punimeve të infrastrukturës lokale;
10. Kryen punë nga lëmi i gjeodezisë për nevoja të drejtorisë;
11. Ruan dokumentacionin e eksproprijimit të pronave gjatë viteve të mëhershme që janë në interes të komunës;
12. Arkivon dokumentacionin teknik të infrastrukturës lokale.
13. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë-veprimtarisë së Drejtorisë;

Neni 12

Organizimi i Drejtorisë së Infrastrukturës

1. Sektori për Projektim
2. Sektori për Infrastrukturë

Neni 13

Sektori për Projektim

1. Bën projekte për infrastrukturë në bazë të 'Planit Zhvillimor Komunal';
2. Përgatitë plane dhe projekte për ndërtimin dhe renovimin e infrastrukturës sipërfaqësore dhe nëntokësore, për objektet ndërtimore publike;
3. Përcjell dhe studion rrjedhat e zhvillimit të infrastrukturës së komunës dhe cakton kriteret e ndërtimit të infrastrukturës rrugore;
4. Përgatitë detyrat projektuese dhe bën kategorizimin e objekteve të infrastrukturës urbane dhe rurale;
5. Bënë vlerësimin e punës së personelit të Sektorit për Projektim dhe raporton për punën e sektorit.

Neni 14
Sektori për Infrastrukturë

1. Merrë pjesë në mbikëqyrjen e projekteve investuese publike komunale;
2. Merrë pjesë në pranimin teknik të projekteve investuese komunale;
3. Përgatitë raporte punë gjatë realizimit të projekteve kapitale publike;
4. Lëshon leje për infrastrukturën rrugore, leje për gropim dhe hapje të kanaleve, të cilat i bëjnë ndërmarrjet publike, si dhe lejet për kyçe individuale të qytetarëve në rrjetin e infrastrukturës.
5. Cakton organin mbikëqyrës për mbikëqyrje dhe komisionin për pranimin teknik të objekteve të ndërtuara, në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit;
6. Është përgjegjës për menaxhimin e mbikëqyrjes, të ndërtimit, rindërtimit dhe sanimit të infrastrukturës rrugore - Kanalizimeve fekale, atmosferike kabllore, ujësjellësin asfaltimin, ndriçimin publik, sinjalizimin horizontal dhe vertikal, për objektet e institucioneve shkollore, shëndetësore, rekreative dhe sportive, parqeve në qytet dhe vise rurale;
7. Bëjnë vlerësimin e punës së personelit të Sektorit për Infrastrukturë dhe raporton për punën e sektorit.

Neni 15
Drejtoria e Pronës

1. Menaxhon me pronën në pronësi komunale;
2. Mban shënime për tokën dhe objektet në pronësi të Komunës;
3. Zhvillon procedurën e shpronësimit të tokës në pronësi private dhe shoqërore për ngastrat e planifikuara për interes publik sipas planeve urbanistike të Komunës;
4. Përgatitë vendimet e shpronësimit për personat fizikë dhe juridikë;
5. Arrin marrëveshje dhe nënshkruan kontrata me anë të së cilave siguron tokën e nevojshme për realizimin e interesit publik;
6. Nxjerr vendime për regjistrimin e të drejtës së pronësisë në emër të Komunës, në paluajtshmëritë e mbetura pa pronar;
7. Trajton dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;
8. Nxjerr vendimet për lirimin e pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
9. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore - juridikë lidhur me pronën komunale;
10. Zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
11. Përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore-juridike;
12. Përgatitë iniciimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
13. Përcjellë vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikun në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;

14. Thërret dhe njofton palët e interesit për nxjerrjen e vendimit të shpronësimit;
15. Bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë e linjës, për të dhënat gjeodezike dhe ato pronësore;
16. Bën identifikimin, klasifikimin dhe vlerësimin e pronës së paluajtshme;
17. Koordinon punën me drejtorinë kompetente për punët e ndërtimit dhe të kadastrit, në aspektin e lejeve e të ndërtimit dhe të dhënave tjera kadastrale;
18. Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushëveprimtarisë së Drejtorisë;
19. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Pronës është e organizuar në këta sektorë.

Neni 16

Organizimi i Drejtorisë së Pronës

1. Sektori i Pronës
2. Sektori për Shpronësime dhe Këmbime

Neni 17

Sektori i Pronës

1. Bën shqyrtimin dhe zhvillon procedurën administrative për uzurpimet arbitrare të tokës në pronësi të Komunës;
2. Nxjerr vendimet për lirim të pronës komunale të uzurpuar arbitrarisht;
3. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e personave fizikë dhe juridikë në procedurë administrative, për rregullimin e marrëdhënieve pronësore - juridikë lidhur me pronën komunale;
4. Zhvillon procedurat administrative, sipas detyrës zyrtare për ruajtjen e pronës komunale dhe interesit tjetër komunal;
5. Përpunon konkluzionet pas plotfuqishmërisë së vendimit në procedurë administrative dhe pronësore-juridike;
6. Përgatitë iniciimin e procedurës për kallëzim penal, së bashku me përfaqësuesin juridik të Komunës, lidhur me uzurpimet arbitrare të pronës komunale;
7. Bën vlerësimin e punës së personelit të Sektorit për Pronë dhe raporton për punën e sektorit.

Neni 18

Sektori për Shpronësim dhe Këmbime

1. Shqyrton kërkesat për shpronësime që realizohen për interesin publik;
2. Përcjellë vendimet që kanë të bëjnë me shpronësimet për publikun në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
3. Thërret dhe njofton palët e interesit për nxjerrjen e vendimit të shpronësimit;
4. Shqyrton kërkesat për këmbimin e pronës për palët e interesuara;
5. Shqyrton kërkesat për dhënie në shfrytëzim të pronës për rastet të veçanta;
6. Bën vlerësimin e punës së personelit të Sektorit për shpronësim dhe këmbime dhe raporton për punën e sektorit.

Neni 19
Drejtoria për Teknologji Inovacion dhe Integritime Evropiane

1. Minisori i Drejtorisë për Teknologji dhe Inovacion është hulumtimi, propozimet dhe hartimi i politikave për fushën e Teknologjisë dhe Inovacionit në nivelin komunal, në përputhje me organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës Komunale;
2. Harton planin e punës;
3. Hartimi dhe zhvillimi i strategjisë, programeve dhe planeve për të arritur qëllimet;
4. Propozon, harton dhe kujdeset për zbatimin e dokumenteve të politikave në fushën e Teknologjisë dhe Inovacionit;
5. Harton rregullore komunale për fushën e vet;
6. Propozon aktivitete dhe iniciativa inovative në favor të zhvillimit të Administratës Komunale - Sektorëve;
7. Hulumton, inicion, përkrah dhe promovon projekte nga fusha e Teknologjisë dhe Inovacionit të të gjithë sektorëve të Administratës me prioritetet e tyre, në ndikim për zhvillim të qëndrueshëm komunal;
8. Bashkëpunon me institucionet në rrafshin horizontal dhe vertikal për nxitjen, përkrahjen dhe promovimin e ideve, proceseve dhe shërbimeve inovative;
9. Merret me iniciimin për sa i përket krijimit të mekanizmave koordinues, organizimit dhe funksionimit, në funksion të informimit dhe aplikimit të proceseve teknologjike;
10. Udhëheq dhe koordinon aktivitetet për sa i përket politikave për përkrahjen dhe ngritjen e kapaciteteve, stimulimin dhe orientimin për fushën e inovacionit për administratën sektorët e veçantë, për të rinjtë, komunitetin e biznesit dhe shoqërinë civile;
11. Ndihmon në realizimin e obligimeve të komunës të cilat dalin nga Planet e Veprimit për Integritime Evropiane;
12. Koordinon aktivitetet e komunës të cilat janë të ndërlidhura me zbatimin e planeve të veprimit;
13. Koordinon aktivitetet e drejtorive, me dokumentet strategjike të Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe komunës, që burojnë nga planet e veprimit;
14. Siguron që hartimi i rregulloreve komunale, të jenë në përputhshmëri me standardet evropiane;
15. Përgatitë material të nevojshme të komunës, për çështjet që lidhen me integritime evropiane;
16. Hulumton programe të ndryshme të asistencës së Bashkimit Evropian, që ofrojnë mbështetje për qeverisje dhe zhvillim rajonal dhe lokal;
17. Bën planifikimin e buxhetit nga fushëveprimtaria e saj;
18. Bën vlerësimin dhe raporton për punën e Drejtorisë.

Neni 20
Organizimi i Drejtorisë së Teknologjisë Inovacion dhe Integritime Evropiane

1. Sektori për Teknologji dhe Inovacion
2. Sektori për integritime evropiane

Neni 21
Sektori për Teknologji dhe Inovacion

1. Mbikqyrë implementimin e projekteve në Teknologji;
2. Ofrimi digjital i shërbimeve të orientuara drejt qytetarëve;
3. Shfrytëzimi i teknologjisë digjitale për të përmirësuar proceset e punës dhe menaxhimit;
4. Implementimi i një infrastrukture fleksibile të sigurtë dhe të mbrojtur;
5. Trajnimi dhe zhvillimi i shërbyesve civil për Teknologji Digjitale për të përmirësuar proceset e punës dhe menaxhimit brenda institucioneve publike;
6. Implementimi i mekanizmave ligjor, rregulloreve, standardeve nga fusha e teknologjisë;
7. Vlerësimi i punës së personelit dhe raportimi për sektorin;
8. Vendorsje e qëllimeve strategjike dhe taktike;
9. Zhvillimi i sistemit të strategjisë, me qëllim të arritjes së objektivave;
10. Analiza e infrastrukturës, diagnoza e situatës aktuale;
11. Përcaktimi i burimeve të nevojshme dhe shpërndarja e tyre sipas qëllimeve;
12. Menaxhimi operacional dhe i kontrollit të brendshëm;
13. Menaxhimi organizativ, teknik dhe teknologjik;
14. Analiza dhe vlerësimi i projekteve të inovacionit;
15. Zgjedhja e procesit të inovacionit;
16. Vlerësimi i efektivitetit të proceseve të inovacionit;
17. Procedurat për marrjen e vendimeve të menaxhimit;
18. Eliminimi i rreziqeve dhe menaxhimi i riskut;
19. Vlerësimi i punës së personelit dhe raportimi për sektorin.

Neni 22
Sektori për integritime evropiane

1. I ofron mbështetje dhe këshilla profesionale kryetarit të komunës dhe drejtorëve komunal në përcaktimin e prioriteteve të komunës në fushën e integrimit evropian, duke marrë parasysh obligimet që dalin për komunën nga dokumentet strategjike nacionale për integrim evropian;
2. Koordinon punën dhe zhvillon konsultime me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministrinë tjera, për harmonizim të prioriteteve dhe politikave të komunës me dokumentet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës;

3. Monitoron, vlerëson dhe raporton lidhur me implementimin e prioriteteve dhe dokumenteve strategjike të komunës që dalin nga dialogu i procesit të stabilizim-asocimit, si dhe siguron reflektimin e sfidave të identifikuara në caktimin e prioriteteve të komunës për integrim evropian dhe të planeve të punës për integrim evropian;
4. Raporton rregullisht te Kryetari i Komunës për aktivitetet e drejtorive e të cilt ndërlidhën me obligimet e tyre nga Agjenda Evropiane;
5. Bashkëpunon me Zyrën për Integritim Evropiane në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në çështjet e përafritimit të legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian;
6. Mbledh informacione dhe konsultohet me ministrinë përgjegjëse për integrim evropian për të siguruar zbatimin e politikave dhe udhëzimeve në përputhje me politikat kombëtare;
7. Bën monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e rregullt të implementimit të prioriteteve dhe dokumenteve strategjike të Komunës, si dhe të aktiviteteve relevante në kuadër të dokumenteve strategjike nacionale për integrim evropian dhe obligimeve të Komunës që dalin nga marrëdhëniet Kosovë-Bashkim Evropian;
8. Koordinohet dhe konsultohet ngushtë me strukturat udhëheqëse komunale Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Drejtoret e Drejtorive dhe strukturat e tjera relevante komunale, si dhe me strukturat qendrore Ministrinë Përgjegjëse për Qeverisje Lokale dhe atë të Integritimit Evropian, për të siguruar pajtueshmërinë e kornizës rregullative dhe të politikave komunale me standardet e Bashkimit Evropian;
9. Koordinohet ngushtë me Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e Kuvendit Komunal dhe Drejtoret e Drejtorive, si dhe me të gjitha strukturat e tjera vendimmarrëse komunale, në zhvillimin dhe avancimin e kornizës rregullative dhe të politikave të Komunës;
10. Në përmbushjen e detyrave sektori bashkërendon punën në mënyrë të rregullt me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera perkatëse;
11. Vlerësimi i punës së personelit dhe raportimi për sektorin.

Neni 23

Ky ndryshim-plotësim i kësaj Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Nr. _____ 2022

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO	
Nr.faq/Br.str.		96
Datë/Datum		31.03.2022
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		



Datë: 31.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 74, të datës 15.03.2022, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14, nenin 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra

1. Për themelimin e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej: pesë (5) anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Krenar Dumani - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, anëtar;
 - 1.2 Hasan Ismajli - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, anëtare
 - 1.3 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Kuvendit të Komunës nga Iniciativa e Fushë-Kosovës për Ashkali dhe Egjiptian dhe Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, anëtar
 - 1.4 Lirije Thaqi Xhigoli - anëtare dhe
 - 1.5 Hava Avdullahu - anëtare.
- 2 Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra janë të definuara në nenin 10, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017 për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.
- 3 Kryesuesi dhe Zëvendës Kryesuesi i Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra zgjidhen nga anëtarët e komitetit.
- 4 Mandati i anëtarëve të Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

- 5 Raportimi për punën e tyre, është raportim vjetor në Kuvendin e Komunës, kurse kompenzimi i anëtarëve të komitetit, bëhet nga buxheti i komunës për gjashtë mbledhje në vitë, sipas nenit 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera.
- 6 Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komitetit për Bujqësi Mjedis dhe Ujëra, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.04.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.03.2022, pas shqyrtimit të Kërkesës Nr. 020-144/4 të datës 22.02.2022, për rishqyrtimin e vendimit Nr. 21, të datës 07.02.2022 për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete në Komunën Fushë-Kosovës, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), 27, të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Nr. 21, i datës 07.02.2022 për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete mbetet në fuqi

1. Vendimi Nr. 21, i datës 07.02.2022, për emërimin e z. Suhat Ademi në pozitën e Nënkryetarit të Komunës për Komunitete mbetet në fuqi, pas rishqyrtimit të kërkesës Nr. 020-144/4 të datës 22.02.2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Nënkryetarit të Komunës për Komunitete, Drejtorisë së FB, Udhëheqëses të Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.03.2022

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2022, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 125, të datës 16.02.2022, paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, mbështetur në kërkesën e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë me Nr. 72, të datës 14.02.2022, të shqyrtuar në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2022

1. Për vazhdimin e mbulimit të shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës me dokumentacion personal të identifikimit, për vitin 2022 në shumë të mjeteve financiare prej 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo ceremoni të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.
2. Sigurimi i mjeteve financiare sipas pikës një të vendimit nga buxheti i komunës, për vitin 2022, është në kompetencë të Drejtorisë së Financave e Buxhetit.
3. Kryerja e procedurave tjera për zbatimin e vendimit është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
4. Për shpenzimin e mjeteve financiare të lejuara, përfaqësuesit e Këshillit të Bashkësisë Islame të Fushë-Kosovës, Kishës Ortodokse dhe bashkësive tjera fetare i raportojnë me shkrim Kuvendit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHPM, Këshillit të Bashkësisë Islame në Fushë-Kosovë, Kishës Ortodokse Serbe në Fushë-Kosovë dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

